



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	22.10.2024
01 NR/BR.	01/324
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim Vendim për lirim-faljen e qirave për lokalin në rr. "Ramadan Rexhepi" në pronësi të Komunës

Në bazë të nenit 58 pika 1. h. të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për;

1. Lirim-faljen e qirave për lokalin me nr. P-72217092-1-3-1-0 me adresë në rr. "Ramadan Rexhepi" në pronësi të Komunës së Ferizajt.
2. Shuma mujore e qirasë prej 540.00 € falet nga muaji 01.01.2023 deri me datë 31.12.2024.
3. Obligohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të bëjë shlyerjen e obligimeve për subjektin juridik Yummy Pita SH.P.K., me numër unik 811885451 për shumën e obligimeve të qirasë sipas pikës 2 të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Subjekti juridik Yummy Pita SH.P.K., përmes përfaqësuesit të saj ka bërë kërkesë për faljen e obligimeve të qirasë sepse me rastin e fillimit të punimeve infrastrukturore të rruga "Ramadan Rexhepi", i është pamundësuar operimi dhe se gjatë kësaj kohe nuk ka mundur të punoj, andaj bazuar në këtë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që të na i falë borgjet e qirasë sepse ne si biznes jemi penalizuar jashtëzakonisht shumë dhe dëmet e shkaktuara janë të parikuperuara.

Andaj bazuar në atë që u tha më lart i propozoj Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendit të Komunës që të aprovoj propozimin në tërësi ashtu siç edhe është prezentuar në dispozitiv.